E kritikojmë sepse shpresojmë në të f.2


Integriteti Akademik në Universitetin "Hasan Prishtina" f.6

Myzhde f.9

Dauti ja nxjerr në pah Rronit! f.13

td

TEMPULLI I DIJES
NUMRI 08 / DHJETOR 2020



TEMPULLI I DIJES • DHJETOR 2020, NUMRI 08

editorial

E KRITIKOJMË SEPSE SHPRESOJMË NË TË



ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim


Templlarët:
Adea Kondirolli
Liridona Ademaj
Indrit Ferati
Valon Dervishaj
Dibran Hoxha
Sara Sylejmani
Skord Retkoceri
Gramos Buçinca
Rron Gjinovci



Dizajni:
Visar Arifaj - Kabineti

Kontakti:
www.orca-ks.org
gazeta.orca@gmail.com
+383 (45) 234 994
Rr. Simon Shiroka,
Prishtinë 10000,
Kosovë





Rron Gjinovci

ORCA zhvilloi takimin e parë zyrtar e formal me rektorin e institucionit më të madh e më cilësor në Kosovë, Universitetin e Prishtinës. Kjo vizitë nuk ishte rastësore. Nuk ishtenjë vizitë kurtuazie me rastin e zgjedhjes së një rektori të ri, por një vizitë e qëllimshme, me mesazh të qartë e të fortë të përkrahjes për vazhdimin e reformave të premtuara në UP.

Takimi u bë i mundshëm sepse rektori aktual është rektori i parë i zgjedhur pa asnjë kontestim publik të zgjedhjes së tij. Është rektori i parë pas një kohe të gjatë i cili përmbush vet kushtet për titullin që mban sipas numrit të publikimeve shkencore. Është rektori i parë që në ekipin e tij të prorektorëve ka 3 gra, gjë që na bënë shpresëmirë për adresimin e çështjes së barazisë gjinore dhe parandalimit të ngacmimeve në universitetin tonë. Ndërkaq, në gjetjet e fundit të hulumtimit tonë Universiteti i Prishtinës është edhe institucioni më transparent i arsimit të lartë në vend, një meritë kjo e menaxhmentit të kaluar por e cila duhet të avancohet nga rektori aktual dhe ekipi i tij. Këto isharete të para pozitive, na bënë neve që me kënaqësi të kërkojmë vizitën tonë të parë zyrtare për ta takuar rektorin dhe ekipin e tij të prorektorëve të cilët përmbushin poashtu kriteret formale të numrit të publikimeve shkencore për të justifikuar titujt akademikë që kanë.

Takimin e zhvilluam në një atmosferë të mirë të korrektësisë e profesionalizmit duke i rikujtuar njëri tjetrit detyrimet që kemi ndaj publikut dhe qëllimit tonë të përbashkët: për avancimin e mëtutjeshëm të cilësisë në arsimin e lartë.

Siç ka ndodhur edhe në të kaluarën, do të mund të ndodhë edhe në të ardhmen, që mospajtime për çështje të ndryshme mes nesh të ketë, por ne mbesim të zotuar që do të ruajmë gjithmonë korrektësinë dhe profesionalizmin për të adresuar së bashku te njëri tjetri çkado që ne e konsiderojmë interes të universitetit e si rrjedhim interes të qytetarëve të vendit. Në këtë frymë ne u dakorduam që: ORCA do ta promovojë kurdoherë çdo arritje pozitive të universitetit, sikundër që do të adresojë publikisht kritikat e saj për dukuritë negative të tij përmes hulumtimeve dhe aktiviteteve të tjera të saj; ORCA do të ofrojë kapacitetet e veta profesionale e financiare në marrjen e ekspertizave të jashtme për të adresuar çështjet që lidhen me integritetin akademik apo aspekte tjera që lidhen me cilësinë e mësimit në UP; ORCA do të vazhdojë monitorimin në sa më shumë organe universitare për t'u siguruar që proceset akademike do të ruajnë standardin e tanishëm apo edhe ta avancojnë atë; Universiteti i Prishtinës do të jetë bashkëpunues në rritjen e mëtutjeshme të transparencës për publikun kosovar duke vazhduar komunikimin e mirë me OJQ-të dhe mediet me qëllim të rritjes së llogaridhënies ndaj publikut; Universiteti i Prishtinës do të konsultojë pa detyrime kontraktuale të gjithë hisedarët me qëllim gjithpërfshirjen e publikut në proceset e veta si universiteti më i madh publik në vend; ORCA dhe Universiteti i Prishtinës do të angazhohen për të promovuar praktikat më të mira të proceseve akademike që lidhen me titujt akademikë dhe jepjen e mundësive për përfshirje në hulumtime dhe publikime shkencore për gjithë stafin akademik, përmes mekanizmave tashmë ekzistent si dhe kyçjes së Kosovës në mekanizma të rinj.

Universiteti i Prishtinës është jashtëzakonisht i rëndësishëm për shoqërinë tonë. Zhvillimi i identitetit tonë shoqëror është historia e zhvillimit të Universitetit. Avancimi i shoqërisë sonë deri sot, s'ka qenë asgjë tjetër veçse avancimi i Universitetit të Prishtinës prej themelimit të tij. S'ka si të jetë ndryshe as në të ardhmen. Se si do të jetë shoqëria jonë në 20, 30, 40, 50 vitet e ardhshme, varet se si është gjendja e Universitetit tonë sot, sepse 90% e të gjitha profesioneve që ushtrohen sot në Kosovë dalin nga Universiteti i Prishtinës. Prandaj ne të gjithë duhet të angazhohemi që universiteti të avancohet akademikisht, të jetë më transparent e më llogaridhënës, me buxhet shumë më të madh e shumë më i çmuar nga politika e shoqëria, sepse dalja nga kriza, ekonomike, politike e shoqërore kalon vetëm nëpër një derë, nëpër derën e universitetit. Ashtu qoftë!

KITU KOALICIONI PËR INTEGRITET DHE TRANSPARENCË NË UNIVERSITET

KFOS Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

ORCA është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet - KITU, mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS. Ky raport është pjesë e programit të KITU-së. Ky grant është realizuar me përkrahjen e projektit Sfidimi i Korrupcionit në Arsimin e Lartë i financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Përmbajtja është përgjegjësi e ORCA dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i KFOS-it.

KRONIKA E ZEZË



Dibran Hoxha,
Valon Dervishaj

Ndërhyrjet e ish-Ambasadorit Gjerman Christian Heldt në AKA

Për gati gjysmë viti në-atë-kohë Ambasadori Christian Heldt kishte ushtru presion sistematik mbi Agjencinë Kosovare të Akreditmit me qëllim t'përshpejtimit të akreditimit të disa programeve të Kolegjit "Heimerer".

Ai përmes një emaili (FOTO) që dukej sikur vinte nga zëdhënësi i Kolegjit Heimerer e jo nga ambasadori i shtetit ma të fuqishëm në Evropë, i drejtohej kryetarit të bordit të Agjencisë prof. Gazmend Luboteni ku me mirësjelljen prej diplomati i theksonte dhe kërkonte gjëra përmes të cilave ia përcaktonte afatet dhe mënyrën e punës së Agjencisë. Por, edhe me korrektësinë politike të përmbledhun në ni paragraf ku shkruante se kjo kurresesi nuk mund të paraqiste një ndërhyrje në procesin e vendosjes meritore nga ana e Agjencisë, ajo përbënte një ndërhyrje flagrante në independencën e institucionit.

Meqë emailat në foto e shpjegojnë krejt ecurinë e kujdesit të shtum të ambasadorit kundrejt kolegjit, atëherë ju ftojmë ta bëni një ushtrim të thjeshtë: shihni emailin e ambasadorit Heldt dhe mbulojeni pjesë e emrit të tij me dorë. Pastaj imagjinoni emrin e një politikani kosovar në vend të tij dhe mendoni si do të kishit reaguar po të ishte shkruar nga një politikan kosovar.

Pavarsisht gjithë këtij presioni, anëtarët e bordit të Agjencisë kishin shqyrtu 3 programe të Kolegjit Heimerer ku vetëm një program u miratua. Kjo pastaj provokoi presionin përfundimtar nga ish kryeministri Haradinaj, i cili më 30 janar 2020 tentoi të bënte ndërhyrjen e tij të fundit nga seria e ndërhyrjeve që Kosovën e përjashtuan nga EQAR dhe ENQA. Kjo letër ishte thirrja e fundit e deshpërimit nga koalicioni i ndërhyrjeve Christian Heldt – ish Qeveria e Kosovës.

Ky denoncim duhet t'jetë shpallje e fitores së përpjekjeve të shoqnisë sonë për t'u çliru nga korrupsioni dhe ndërhyrjet politike e diplomatike në institucionet tona të pavarura.

Është detyrë e secilit prej nesh si qytetar i Republikës, që ta themi të vërtetën çdo herë dhe ndaj çdo kujt sepse siç na mësonte filozofi antik Aristoteli: "Askujt nuk i lejohet të ofendohet nga e vërteta".

MESSAGE FROM AMBASSADOR HELDT:

Dear Mr. Luboteni,

I thank you for your letter dated 7th October 2019 in which you have underlined the commitment of the State Quality Council to a transparent accreditation process which fulfills all relevant criteria according to European standards.

As we have been following the subject closely over the past weeks, we are happy to hear that the experts mission which has visited the Heimerer College on 18th October has sent its preliminary report for comments to the Heimerer Management last week, 4th November. On Saturday 9th November, Heimerer has replied and sent its comments; now the international experts are supposed to forward the final report to KAA/SQC by Wednesday 13th November.

As you know, in order that the Heimerer College can offer the respective programmes to its students in the school year 2019/2020, it is of the highest importance that KAA decides about the accreditation of the programmes as early as possible. Therefore, we encourage you to call the KAA Board Meeting, in which such a decision can be taken, at the earliest possible time, hopefully already by Friday 15th November.

Let me underline again, that under no circumstances want to get involved in the qualitative decision-making of your institution, but solely expect a transparent, fair and timely process for the accreditation that has been pending over several months.

We appreciate your cooperation and look forward to the next steps.

Sincerely

Christian Heldt

Deshi Zenuni të bëhej Rektor!



Fikja e shpresës së "avanturierit" Halili

Në konkursin e zgjedhjes së rektorit të ri të UP-së në korrik të këtij viti, zbuluam edhe nji njeri ambicioz e avanturist të quajtun Zenun Halili.

Pas bamjes publike të kandidaturës së Halilit, na vendosëm me i analizu kredencialet e tij akademike dhe etike, e na doli si vijon:

— Zenun Halili kishte fillu punën në UP në vitin 2003, ndërsa ishte avancu në pozitën e profesorit të asocuar në vitin 2011, pozitë për të cilën i janë dashur 3 punime shkencore në revista ndërkombëtare të cilat atëbotë nuk i kishte.
— Në CV-në e tij të përditësume në faqen e UP-së më 7 korrik të këtij viti, ishte evidentu se deri në vitin 2018 Zenun Halili nuk ka pasë asnjë punim shkencor të publikum në revista kredibile ndërkombëtare.
— Ndërkohë, mediet tashmë kishin raportu se Zenun Halili ka qenë kandidat i AAK-së për deputet në zgjedhjet e vitit 2014, gja që nuk e kishte mohuar as vet Halili.

Zenun Halili kishte dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit të Këshillit Drejtues me qëllim të kandidimit për rektor të UP-së, ky veprim "i matur" i tij i kushtoi me diskualifikim të kandidaturës për rektor, meqë Komisioni Profesional për Propozimin e Listës së Kandidatëve për Rektor në UP konstatoi se kandidimi i zt. Halili përbën shkelje të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionin Publik, ngase ai nuk kishte të drejtë ligjore të emërohet në pozita udhëheqëse në institucionin të cilin e ka mbikëqyrur më parë. Mësohet se në përgjigjen me shkrim ndër të tjera Komisioni i kishte thënë: jo s'të dua Zenun avanturist.

Shpresojmë që aventurat e "Tom Halilit" të mbesin mesazhe

Sabotimet e paarsyeshme të Këshillit Drejtues të UP-së

Në mbledhjen e 1 tetorit 2020 kur ishte parapa me u aprovu propozimi i rektorit për prorektorë, Këshilli Drejtues kishte miratu vetëm një prorektor, profesor Mimoza Ibrani, ndërkaq pa asnjë arsyetim kishte shty votimin për propozimet tjera të rektorit. Tutje, në mbledhjen e dytë të këtij organi më 14 tetor 2020, janë votu edhe tre prorektorë të tjerë të propozum që në fillim nga rektori i UP-së. Megjithatë, zvarritja e këtij procesi ka vazhdu meqë Këshilli Drejtues përsëri nuk e kishte votu propozimin për pozitën e Prorektorit për Zhvillim te Cilësisë, edhe kësaj radhe pas asnjë arsyetim.

Na i kemi hulumtu të gjithë prorektorët e propozum nga rektori Sahiti, dhe ata i kanë përmbush kriteret formale sa i përket numrit të punimeve shkencore t'nevojshme për titujt përkatës akademikë. Por, si duket Këshilli Drejtues ka kritere tjera për aprovime apo refuzime të ktyne pozitave, andaj i lusim që të paktën t'i bëj të dituna këto kritere për publikun.

Krejt këto veprime përbëjnë shkelje të së drejtës së rektorit për përzgjedhjen e ekipit të tij dhe tentativë për ndërhyrje në menaxhment të UP-së nga ana e organit ma të lartë udhëheqës të UP-së. Ndërkaq, kujtojmë se vonesa të tilla të panevojshme kishte edhe në procesin e zgjedhjes së Rektorit të UP-së.

Fakulteti i Arteve me ligjërues të akuzum për përdhunime



Kur krejt ne ishim në karantinë, disa profesorë dhe studentë të Regjisë së Filmit në Fakultetin e Arteve erdhën me një ide briliante, atë të "Festivali Online i Filmit". Në këtë festival u ftu për me mbajt nji masterclass regjisori Paul Haggis. Ky regjisor tash e tre vite po përballet me akuza për ngacmime seksuale dhe përdhunime, po ky fakt nuk e pengoi Fakultetin e Arteve që me nderu me një ftesë për ligjëratë me studentë regjisorin në fjalë.

Përveç tjerash, për këtë festival të filmit ka pasur dezinformata nga profesorët dhe Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të cilët deklaruan se ky Fakultet prodhon 50 filma në vit, kurse Fakulteti i Arteve mezi prodhon 20 filma në vit. Po ashtu, dita e parë e festivalit nuk mundet me u gjet në faqe të fakultetit në rrjete sociale, sepse postimet janë fshi nga Facebook-u për shkak se nji pjesë e madhe e festivalit ishte plagjiaturë.

Dyshime për keqpërdorime në UP

Po bëhen afro 9 muaj qëkur ish anëtarja e Këshillit Drejtues të Universiteti "Hasan Prishina" znj. Laura Kryeziu – Selimi i ishte drejtu me një letër përgjegjëse të këtij institucioni duke i listu një sër shkeljesh administrative e financiare në UP.

Dështimi i konkurseve administrative, dështimi i realizimit të projekteve/investimeve kapitale dhe mosrespektimi i proceduarve të prokurorimit, dyshime mbi të hyrat personale, keqtrajtim të buxhetit, dyshime mbi ligjshmërinë e pozitës aktuale të Sekratarit të Përgjithshëm të UP-së, të gjitha këto të listume dhe argumentume në letrën e znj. Kryeziu – Selimi.

Shpresojmë që menaxhmenti i ri ka me fillu me u marr me adresimin e këtyre denoncimeve dhe mos të e keqinterpretojnë autonominë e këtij institucioni, si e drejtë për mos llogaridhënie, sepse autonomi për me bo keqpërdorime nuk gëzon dhe nuk duhet të gëzojë askush në Kosovë.

Këshilli Shtetëror i Konflikteve

Dyshimet për manipulim e dallavere në akreditimin e disa drejtimeve (programeve) të kolegjeve private, nxorën në pah çarjen mes anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë në Agjenci të Akreditimit.

Prej janarit 2020, lufta mes tyre po vazhdon, herën e fundit këta kundërshtarë të përbetum u përplasën në Komisionin parlamentar për Arsim. Kryetari Gazmend Luboteni me nënkryetaren Vjollca Krasniqi i akuzonin 2 prej anëtarëve vendorë, Rozafa Koliqi dhe Dukagjin Zekën, se janë të jashtëligjshëm, andaj edhe nuk frikësoheshin prej akuzave të cilat edhe kishin përfundu në adresë të Prokurorisë.

Për të gjitha akuzat për keqpërdorim e keqmenaxhim, kryetari e nënkryetarja nuk dhanë përgjigje, e që sipas deputetit, Shpejtim Bulliqi kjo nënkuptonte pranim i fajit. Deputetët u mundun me i pajtu antëtarët e KShC-së por pa sukses, meqenëse dukej se ata vecse kishin heq dorë nga vetja dhe njëri-tjetri.

Pas katër orësh akuza mes njëri-tjetrit, komisioni vendosi që t'i thërras përsëri në një mbledhje tjetër, pasi të qetësoheshin dhe të përgjigjeshin në pyetjet e deputetëve. Por kjo mbledhje e dytë nuk arriti të mbahej asnjëherë sepse qeveria vecse kishte ra në mars të këtij viti, e qeveria e re nuk arriti me u votu deri në qershor. Por mandej edhe Komisioni u ndërru pak në përbërje, edhe e kapën derte tjera!

Perla nga arsimi i lartë


GJETJE THESARI DHE COPËZA ILUMINIMI NGA BËRTHAMA E DITURISË



Indrit Ferati

Kolegë, jadec!

Një grup i profesorëve të Fakultetit të Mjeksisë kanë publiku punimin shkencor mbi ashtin e "jadecit" te ngecun në barkun e pacientit të panjohun.



"Ohhh Lukthiii bre!", ishin fjalët e fundit të personit para se të merrte pjesë në një punim shkencor me disa profesorë të universiteteve pubile në Kosovë. Cdo gjë e keqe ka anën e mirë të saj, edhe nëse pa dashje gëlltet një asht gjigand të jadecit. Fatmirësisht kirurgët u duruan që së pari t'a shkrepin foton e ashtit dhe pastaj të lidhen me të. Redaksia jonë ka pranuar një informatë "me t'nime" nga Fakulteti i Mjeksisë, ku njoftohemi se profesorët janë ndarë në dy ekipe, katër me katër. Mësohet gjithashtu se ende doktorët nuk i'a kanë lëshuar njëri tjetrit.

Ui ar not probllematik gajs


Në rastin përvjetorin e 50 të UP-së publikohet dizajni i punuar nga autori i panjohun.



Në parim ky dizajner mund të konsiderohet si i pa-shkollë, por jo. Nëse analizojmë më thellë do t'a gjejmë gjenialitetin që posedon ai. Kur shikojmë për herë të parë këtë llogo, ato rrethat me përmasa të ndryshme do të na hipnotizojmë. Ne nuk arrijmë ta shohim as numrin 5 që është përpara zeros. Kur na pyet dikush se cfarë përjetori feston Universiteti i Prishtinës, ne do t'i flasim për rrumullakat e llogos. Mund të jetë 60 vjetori, 70, 80, 90, 100, 110, 120, 130, 140, 150, 160, 170, nëse bazohemi në memorien tonë. E gjithë kjo punë e gjatë me dizajnimin e rrumullakave është bërë sepse ai nuk ka qenë i sigurtë se a shkruhet "Universitytet" apo "Universitety". 50 vjetori është për juve që nuk mund të arrini t'a shikoni pes'shen.

Bab, bab kqyr Supermani n'Kosovë!


Profesori Nexhat Qehaja, autor i 43 punimeve shkencore ka publiku website-in e tij me CV-në e tij të frytshme, e cila nga redaksia jonë konsiderohet si CV e një "supermeni".



Cfarë të bën një superman? "Të fluturosh?", "Një refugjat nga planeti tjetër? "Rrahja që i jep mangupëve kur ata nuk sillen si thotë shoqëria?"...JO. Ti je një super-man kur i publikon 43 punime shkencore. 43. Katërdhjetë e tre. "Por, por një super-man duhet t'a ketë një ueb-site të tij" do të thoshte dikush. Dhe ne i themi se mirë e ke Filan (Filani nuk është një person real). Natyrisht se një super-man nuk do t'i besonte faqes së Universitetit të Prishtinës. Nëse Filani (jo Filani në fjalinë para ksaj, një Filan tjetër) do t'a hakonte faqen e UP-së, super-mani nuk do të mundej t'i kujtoj të gjitha titujt e punimeve shkencore të tij dhe kjo është e vetmja dobësi e supermanit. Filani (Filani i fjalisë së parë) kishte me thënë "Për msysh".

Hajt nja kishe s'po kqyri

Në webfaqen e Universitetit të Mitrovicës njëra nga CV-të përmban foton në të cilën nuk mund të identifikohet subjekti. Arsyeja prapa kësaj është ende enigmatike për redaksinë tonë.



Të gjithë ju fansa të "Tempullit të Dijes" që fotot tuaja janë krijuar në formatin "dua-të-bëhem-kinse-nuk-jam-i-vetëdijshëm-për-kamerën-që-kam-përpara", mund t'i postoni në facebook ose në instagram dhe pastaj të merrni një koment klishe nga një mik i juaji të formatit "shiko- shiko-ti-mik-i-imi-kinse-nuk-je-i-vetëdijshëm-për-kamerën-që-ke-përpara". Pra në instagram, jo në CV-në tënde.

Mungesa e fleksibilitetit t'len rrugëve


Kolegji Iliria shpërndanë në facebook mundësinë për studentët e tyne ambicioz që të bëjnë punë sezonale në Dubai.



Një punëtor i lodhet i "Tempullit të Dijes" është ankuar tek bo$$at e gazetës duke thënë "Pse s'pe shesim kit t'q*m none? Hala asni cent se nxorëm". Natyrisht se Bo$$at thanë: "E kush e blen?" dhe kështu punëtori la punën. Si student i kolegjit Iliria shfrytëzoi mundësinë për aplikuar për të punuar në Dubai. Ai doli nga ndërtesa e madhe e "Tempullit të Dijes", mori një taxi ilegal dhe mbërrijti tek Kolegji Iliria. Ai hyri brenda, përfundoi aplikacionin dhe pas tre ditësh mori një telefonatë nga një person i cili i tha: "Ku je nis o daj me kit munges t'fokusit për sukses?". Ai la telefonin në vend dhe erdhi tek ne në gjunjë duke u lutur t'a kthenim në punë. Ne nuk e pranuam pasi tashmë kishim informacion se ai studion në Kolegjin Iliria.

E pashë Skenderajin në ëndërr...ai kishte një Fakultet

Ahmet Latifi ka publikuar një punim shkencor dhe deklarohet në këtë punim se vie nga Universiteti jo-ekzistent i Skenderajit.



"Nxeht o kam vjen edhe pse po rrim larg, hajde ma ngat hajde ma ngat" është njëri nga tekstet e këngtares Leonora Jakupit që vjen nga Skenderaji. Këtë e garantojmë me emrat tonë. Por për Ahmet Latifin e gjithë redaksia është në gjendje të mblidhet në ora 14:00 tek sheshi Skënderbe dhe të renditur të bëjnë be një nga një be se ai nuk vjen nga Fakulteti i Skenderajit. Po ashtu do t'a krijojmë një komision të pavarur i cili mbikqyrë se mos dikush bën be rrejshëm. Ky komision i njejtë do të merret me hulumtime dhe do të na përcaktoj se me çka të bëjmë be secili...ose ndoshta më mirë do të ishte nëse ky komision të vëzhgoj Universitetin e Mitrovicës.



Integriteti Akademik në Universitetin “Hasan Prishtina”

Gramos Buçinca

Erdh koha me tregu për hulumtimin ma t’dashtun që e bojna në ORCA, integritetin akademik në Universitetin e Prishtinës (UP). Ky hulumtim u publiku si raport kah mesi i 2020 (hulumtimi i 2019), me titullin e plotë “Integriteti akademik, publikimi shkencor dhe justifikimi i titujve akademikë në Universitetin e Prishtinës”, dhe me i ra shkurt gjendja u përmirësu, por nuk është e mirë. Por, detajet janë specialiteti jone, edhe menxi presim me kallzu çka kemi gjetë :D.

Këtë hulumtim ORCA e bon qe tri vjet, prej 2017-s. Duke u inspiru prej trinitisë së shejtë, na vendosëm me bo një analizë tre vjeçare që tregon se si kanë ndryshuar gjanat ndër vite. Sivjet indikatorët kryesore si numri i publikimeve shkencore, numri i publikimve në revista mashtruese dhe justifikimi i titujve, ia kemi i nda në grupmosha, ma të rinj se 40 vjeç, me 40 dhe 50, dhe ma të vjetër se 50 vjeç. Profesorët e rinj qëndrojnë shumë më mirë me integritet akademik. Disa prej këtyre indikatorëve i kemi nda edhe në gjini. Me i ra shkurt, gratë dalin larg ma mirë se burrat gati në të gjitha indikatorë. Kush o ma i forti? Afrime robotja?

“Po detajet bre...”, qe qitash :P.


Në 2019 në UP i kemi evidentu 2024 punime shkencore të publikuara që nga 1988 (punimi i parë), 307 ma shume se 2018 dhe 722 ma shume se 2017. Ky numër është rritë edhe si pasojë e përditësimit të CV-ve, pra ka pasë punime ma herët që s’janë tregu në CV – ku ORCA i ka marrë të dhënat. Sidoqoftë për me tregu impaktin e ORCA-s mjafton me ditë se 25% e krejt publikimeve shkencore në UP – institucion i themeluar në 1969 – janë bo prej që ekziston ORCA. Pra, 3 vjet e fundit 1/4, 47 vjet e tjera 3/4.


186 profesorë nuk kanë asnjë punim shkencor të listuar në CV-të e tyre. 121 prej tyre janë mbi 50 vjet dhe shumica janë në fakultetet: Mjekësi (30), Juridik (21) dhe i Filologji (20). Vetëm 36 (19%) janë gra, ndërkaq 150 (81%) janë burra.


Mesatarja e punimeve shkencore për profesor në UP është 4.26. Duke pasur parasysh që 186 profesorë nuk kanë fare punime shkencore, mesatarja e punimeve për profesor mes atyre që kanë publikuar të paktën një punim do të dilte 7 punime për profesor. Fakulteti me mesataren më të lartë të punimeve për profesor është Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore (FShMN) me 8.89 punime për profesor. Ndërkaq, nga shkencat shoqërore mesataren më të lartë vazhdon ta ketë Fakulteti i Edukimit me 3 punime për profesor. Ndonëse ka pasur rritje në krahasim me vitin 2018, Fakulteti Filozofik për vitin 2019 bie nën Fakultetin e Shkencave Sportive dhe është i fundit me 1.22 punime për profesor. Fakulteti me më së shumti punime shkencore është FSHMN me gjithsej 587. Fakulteti me më së paku punime shkencore është Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit (FEFS) me gjithsej 22. Profesorët e shkencave shoqërore, për nga numri i publikimeve shkencore mbesin shumë më mbrapa kolegëve të tyre nga shkencat ekzakte. – qiky paragraf u marr prej raportit, qato është i shkrum i tëri n’standard :P.

152 profesorë kanë publiku 532 punime në revista të dyshimta, pak ma shume se evidentimi në 2018. Prej 152, 101 (66%) janë burra, dhe 51 (34%) janë gra. Çka është për mu gzu: në 2019 i kemi evidentu veç 3 punime publikuara në revista të dyshimta.

Edhe në kontaktet e tjera, na në ORCA e kemi kuptu që kërrkush mo nuk po ngulet me publiku në revista të listuara si të dyshimta. Tash, si puna e disa supermenëve që spo i përmendim me emër e dijnë ata vet, profesorët po i gjejnë ca revista të dyshimta, po që po







qillojnë të indeksuara në SCOPUS, kur ata po dojnë me publiku. E mandej kur po i përjashton SCOPUS-i, profesorët po thojnë “po n’rregull u kon at’here” – n’rregull, n’rregull, veq kur revista e boton punimin plagjiat, e me gabime skandaloze gjuhësore, pa të përmirësu, ti si profesor duhesh me ditë që diçka so n’rregull.

Sa i përket justifikimit të titujve, pra a kanë profesorët mjaftueshëm punime shkencore për mu thirrë profesor: në vitin 2019, 55% (262 nga 479) e tyre nuk i justifikojnë titujt. Ndonëse ky është një përmirësim nga vitet e kaluara kur përqindja ishte 72% në vitin 2017 dhe 59% në vitin 2018, gjendja mbetet e rëndë. E me ja shti lapsin, profesorët i kanë borxh Universitetit të Prishtinës 724 punime shkencore.

Sa ma i lartë titulli akademik dhe sa ma i vjetër profesori, aq ma shumë nuk e justifikohet titullin. Bile me qillu burrë edhe ma pak. Veq 40% e burrave e justifikojnë titullin, në krahasim me 60% të grave. Profesorët e FShMN-së qëndrojnë mas miri me justifikim të titullit (70%), e ata të FEFS (8%), ma s’dobti.

Personi më i ri në moshë me titullin akademik “profesor i rregullt”, pra që ka kontratë permanente të punës, që nuk e justifikon këtë titull, do të pensionohet në vitin 2040. ehaa.

Me i kuptu informatat për secilin fakultet, për krejt këta indikatorë ... “lexone vlla raportin!”.


Universiteti i Prishtinës ndonëse keq i ka punët, është shumë ma mirë sesa universitetet tjera publike, e edhe kolegjet private, sa i përket integritetit akademik të mësimdhënësve. UP është përmirësu shumë nga 2017, e pak prej 2018. Na në ORCA mendojmë që UP mundet me u përmirësu ma shpejt. E në kët përpjekje të UP-së, universitetet e tjera publike qare s’kanë pa vrapu pas saj.

Integriteti akademik në Universitetin e Pejës dhe të Prizrenit



Skord Retkoceri

Pas 3 vjet hulumtim të publikimit shkencor dhe justifikimit të titujve të profesorëve në Universitetin e Prishtinës, vendosëm me e zgjeru hulumtimin edhe te 6 universitetet tjera që u patën hapë në kohë fushate zgjedhore. Ma poshtë mund t’i gjeni të dhanat nga hulumtimi për Universitetin e Pejës dhe të Prizrenit të publikume në muajin shkurt të vitit 2020.



Universiteti i Pejës

Sipas CV-ve që i kanë publiku në faqe të universitetit del se 33 profesorë i kanë publiku veç 23 punime në revista shkencore si autor i parë apo korrespodent. Parameno, as ka nji punim s’paku se kanë. Çka është hala ma keq, 22 profesora nuk e kanë asnji punim shkencor. E për me kanë profesor duhet së paku nji punim me pasë për pozitën profesor asistent, e pesë punime për pozitën ma të naltë, profesor i rregullt.

15 profesorë, pra gati gjysa, kanë publiku 83 punime në revista të dyshimta. Pra gati 4 herë më shumë ka punime në revista të dyshimta sesa në revista të mirëfillta shkencore. Megjithatë ka pak shpresë, siç mund të shihet prej grafikut ka rënie të këtij lloji të publikimit. Përderisa në vitin 2015 janë publiku 28 punime të tilla, në vitin 2018 nuk ka asnjë publikim të tillë.

Sa i përket justifikimit të titujve, prej 33 profesorëve, veç 9 profesorë i justifikojnë titujt akademikë. Kjo do të thotë që veç 30% e profesorëve i kanë punimet e mjaftushme për me i justifiku titujt.


Universiteti i Prizrenit

Pak ma mirë qëndron Universiteti i Prizrenit. Sipas CV-ve që janë të publikume në faqe të universitetit, 56 profesorë i kanë publiku 55 punime si autor i parë apo korrespodent. 31 profesorë apo 55% nuk e kanë publiku asnjë punim në revista shkencore.

37 profesorë në këtë universitet kanë publiku 120 punime në revista të dyshimta. Pra ka rreth dyfish ma shumë publikme në revista të dyshimta sesa në revista të mirëfillta. Edhe në këtë universitet viteve të fundit ka rënie të publikimeve në revista të dyshimta.

Sa i përket justifikimit të titujve, 20 nga 56 profesorë apo 36% nuk i justifikojnë titujt akademikë, pra nuk i kanë punimet e mjaftushme për titullin.

Duhet me pas parasyshë që profesorët mujnë mos me i pasë të përditësume CV-te e tyre, e që ka mundësi që numri i punimeve shkencore në revista të mirëfillta me qenë ma i lartë. Po ashtu profesorët jo gjithmonë e dijnë që janë tu publiku në revista të dyshimta.



Këto të dhëna janë nga raportet “Integriteti Akademik dhe Publikimi Shkencor në Universitetin e Pejës” dhe “Integriteti Akademik dhe Publikimi Shkencor në Universitetin e Prizrenit”. Këto raporte me detaje për secilin fakultet mundeni me i gjetë në uebfaqen tonë: vwww.orca-ks.org/publikimet.

Pare, pare, pare...





Liridona Ademaj

Në tetor të këtij viti, ORCA pati publiku dy raporte për universitetet publike në vendin tonë. Njëri ka të bëj me informimin e studentëve nga ana e universiteteve dhe tjetri me menaxhimin e financave nga po të njëjtat.

Kur jemi tek informimi, universitetet obligohen me i publiku rregulloret, vendimet e informacionet e nevojshme në faqen zyrtare të universitetit. Shumica e universiteteve publike janë përmirësu n'këtë aspekt vitin e fundit, mirëpo shumë prej tyre ende nuk e kanë publiku raportin student/mësimdhënës, rregulloren për studimet e doktoratës, rregulloren për SEMS dhe buxhetin.

Hala s'po lojnë me i prekë në pare edhe s'po e publikojnë raportin student/mësimdhënës që me na tregu se a i meritojnë përnime gjithë ato pare.

Se qysh i menaxhojnë ato financa, ORCA ka tregu përmes një raporti që vetëm për vitin 2019, nga buxheti i përgjithshëm për universitete publike janë nda 53 milionë euro, 65% e të cilave shkojnë vetëm për Universitetin e Prishtinës.

Në hulumtimin e deklaratave të pasurisë të stafit akademik menaxherial të të gjitha universiteteve publike për vitin 2019, ORCA ka gjetur se 159 profesorë me pozita menaxheriale në universitetet publike të Kosovës paguhen mesatarisht 1916 euro në muaj, nga të cilat mbi 696 euro janë shtesa (36% e të ardhurave mujore). E këtu mundet me ju kujtohet ajo fraza 't'mbulum n'pare'.

Rektorët e universiteteve publike paguhen mesatarisht 2597 Euro në muaj, nga të cilat mesatarisht 1243 Euro janë shtesa; Prorektorët e universiteteve publike paguhen mesatarisht 2132 Euro në muaj, nga të cilat mesatarisht 863 Euro janë shtesa; Dekanët e universiteteve publike paguhen mesatarisht 2066 Euro në muaj, nga të cilat mesatarisht 837 Euro janë shtesa; Prodekanët e universiteteve publike paguhen mesatarisht 1798 Euro në muaj, nga të cilat mesatarisht 581 Euro janë shtesa.

Ndërkohë që kampioni i gjithë kësaj maratone se kush e ka rrogën ma t'naltë është Bajram Kosumi, rektor i Universitetit të Gjilanit, i cili merr 2973 Euro në muaj. D.m.th. njeri i vetëm që mundet me e xhelozu madje edhe vet presidenti sa i përket rrogës që e merr. (Paga e presidentit, është 2,390 euro në muaj.)

Ridiplomoni kolegë, ridiplomoni!

Çdo vit universitetet private në Shqipëri vazhdojnë me prodhu qindra doktorë shkence, bash si me kon fabrikë. E këta doktorë shkence, mandej synojnë me u bo profesorë në universitete ose kolegje në Kosovë (sidomos ata që janë kosovarë).

Viteve të fundit, njohja e diplomave nga universitetet ose kolegjet private që vijnë nga Shqipëria, është vështirësu. Kjo për shkak se Qendra për Njohjen e Diplomave (NARIC) në Kosovë i ka zbulu disa parregullsi në këto diploma.

Ka raste kur personave që veç kanë diplomu po iu lejohet me ridiplomu. D.m.th. nëse s'i ka pëlqy veshja ose modeli i flokëve kandidatit/es kur ka diplomu herën e parë, tash e ka shansin me u përmirësu.

E ty tash me siguri të intereson me dit se qysh bohet një ridiplomim ose për çka mundet me iu dashtë ai nëse veç ka diplomu njëherë?

Mbasi ta kesh marrë diplomën në Shqipëri, nëse don me punu në Kosovë, duhet me shku në NARIC për me t'u kontrollu vlefshmëria e diplomës, pra kjo qendër e vërteton me Ministrinë e Arsimit në Shqipëri, nëse ti përnjëmend i ki kry studimet në një kolegj ose universitet, i cili i ka plotësu kushtet për me jep mësim.

Nëse një institucion arsimor ose një program studimi nuk është i akreditum, atëherë diploma jote nuk mundet me u njoftë si e vlefshme. Mirëpo shumë studentë, këtë e kuptojnë vetëm kur iu duhet me e nostrifiku diplomën në NARIC (kur don me dal jashtë vendit).

Tash, nëse programi ose institucioni nuk ka pasë akreditim ose çfarëdo problemi tjetër, Ministria e Arsimit në Shqipëri po thonë që nuk marrin përgjegjësi për diploma të tilla. E kur shteti në të cilin janë kry këto studime nuk e njeh atë diplomë, qysh me e njoftë një shtet tjetër?

Disa persona, pasi po shkojnë me ridiplomu në Shqipëri, kryesisht me ndërru datën e diplomimit, po vijnë në NARIC në Kosovë edhe po kërkojnë me ua njoftë diplomën e njëjtë të cilën herën e parë nuk ua kanë njoftë.

Kjo është sikur me mendu që zyrtarëve të kësaj qendre, herën e parë kur ki apliku për njohje e që t'kanë jep vendim negativ, nuk i paska pëlqy data në të cilën ki diplomu se jo që ki pas ndonjë problem tjetër. Po provoni kolegë, prapë provoni çka me ju thonë?!

Ngjitju bjeshkës nëse s't'vlen diploma!

Kur universitetet tona publike vendosën me ia mbyllë derën disa të rinjve që synonin me ia nis me studiu, kolegjet private u bënë shpëtimtaret e ëndrrave të këtyre të rinjve.

Pasi morën titullin student, ishin kohëna t'gëzume për ta, nisën me i ndjekë ligjëratat, me lexu libra, me hy në provime, e pothuajse krejt nëpër çka edhe një student në universitet publik zakonisht kalon.

I kaluan 3-4 vjet tu thur andrra për të ardhmen, dikush synonte m'i vazhdu studimet jashtë vendit, dikush në po atë kolegj, e dikush-dikush me nis me lypë punë pas diplomimit.

Andrrat e planet nisën me iu rrënu, veç pasi shkonin në Ministri të Arsimit me e vërtetu diplomën që e kishin fitu me mund, e me pare shumë.

Disa prej tyre, aty njoftoheshin që diploma e tyre nuk njihej ligjërisht dhe se ato vite e pare nuk mund të kurorëzoheshin me një diplomë të vlefshme. Shumë shpejtë, shpëtimtari i tyre kthehej në një mashtrues.

Njëra nga kolegjet private të cilat gjatë vitit 2019, regjistroi nga 120 studentë në programet që s'kishte akreditim, arsyetohej duke thanë se kolegjet simotra viteve të kaluara regjistronin mbi 1000 studentë dhe se "fillimi i mësimit për 150 kandidatët e rekrutuar po bëhet si bjeshkë në opinion" .

Probleme me tejkalim të numrit të studentëve në programe ku ishte i kufizum numri i tyre, e që janë raportu deri tash kanë studentët e Kolegjit AAB , Kolegjit UBT , Kolegjit Heimerer , Kolegjit FAMA , e ndoshta ka hala!

D.m.th. çka ka dert që këta studentë s'kanë me marr asniherë një diplomë të vlefshme? E rëndësishme është që ata kanë mësu diçka gjatë atyre tri vjetëve. Në një vend me gjithë këtë papunësi, nuk është e thënë krejtve me iu dashtë diploma a?

Ani çka që ti i ke ndihmu një biznesi vendor me ato mijëshe për të paktën tri vite? Diqysh duhet me mbijetu edhe ata!

Qysh pati thonë edhe Kolegji Rezonanca, nuk është nevoja me e bo bjeshkë që paskeni jep shumë pare e s'po iu vlen diploma. Me rëndësi me pas qarkullim!

Breaking news! Exclusive English content on higher education coming to you

If you have been following our exclusive content on Tempulli i Dijes (Temple of Knowledge) newspaper and you have been feeling left out because you don't know Albanian (you should learn btw), your misery ends now, our dear international friends. Yours truly, Adea, will provide an overview (this one will be annual, but in the future maybe more frequently, idk, depends) of all the things that happened in higher education in Kosovo during 2020, and ORCA's work during this year.

Buckle up.



Lexues t'dashtun, na falni veç pak, sa t'ju kallxojmë ktyne t'jashtit ku i kena bazat.

Adea Kondirolli

BREAKING NEWS

Despite a global pandemic that halted MANY processes globally and locally, Kosovo higher education was quite productive (scandals wise) this year.

We started the year with a political standstill, since after the October 6 elections, it took us four months to vote the new government, led by Bini-boy (Albin Kurti, Vetevendosje), in coalition with Dulla-boy (Avdullah Hoti, LDK). LDK got the Ministry of Education, and all was well.

In the meantime, ORCA conducted research on transparency and accountability in all public universities, publishing two reports in January 2020. The first report dealt with finance management, specifically the personal income of academic staff with managing positions in public universities. Contrary to our expectations, the report was not dry, and produced sensational data. We found that some rectors of public universities, and some deans of academic units in those universities get paid over 2000, some even over 3000 euros per month. Quite a lot more than our President or Prime Minister. The second report dealt with transparency of internal management of the universities. Based on our "plucked out of thin air" criteria, we looked at the public universities whether they have 27 documents that we deemed important for the functioning of those universities. Then we graded the universities on their transparency, with 6 out of 7 universities passing the exam, which was an improvement from the first time we did this research one year before.

Intermezzo: we now have an English version of our website so like and subscribe, or just look at it I guess. You can find our reports in English, our mission, and our financial statements. Enjoy.

Anyway, in February, ORCA was especially productive, publishing a total of three reports. The first report looked at the academic integrity of the University of Peja, and we found that there are a total number of 23 credible scientific papers in that University, for 33 professors. 70% of the professors in this university do not justify their academic ranks based on the criteria of the number of papers required to be elected or promoted.

The same research was conducted in the University of Prizren, where we found that they have 55 papers from 56 professors in total. 64% of the

Myzhde! Përmbledhja e ngjarjeve në arsim të lartë për vitin 2020

Ja nisi si shërbim veç për t'hujtit, po kryeredaktori lypi edhe n'shqip.

Ky edicion i Tempullit të Dijes është pak a shumë një përmbledhje e vitit 2020 në arsim në Kosovë. E kush ma mirë me shkru përmbledhje t'vitit, se nji person që so konë hiq në Kosovë deri më 15 shtator.

Pe nisim.

Ndërhyrje e lehtë: ORCA tash i ka t'publikume pasqyrat financiare të granteve të saj, në emën të transparencës. Knaqnu.

Pavarësisht pandemisë globale që i ndërprejti plot procese globalisht e lokalisht, arsimi i naltë n'Kosovë ishte mjaft produktiv (sa i përket skandaleve) këtë vit.

E fillum vitin me nji bllokadë politike, meqenëse mbas zgjedhjeve të 6 tetorit, na u deshtën katër muj me votu qeverinë e re, n'krye me Binin (Albin Kurti, Vetëvendosje), në koalicion me Dullen (Avdullah Hoti, LDK). Me këtë rast LDK-ja e mur Ministrinë e Arsimit, e krejt u bonen mirë.

Ndërkohë, ORCA ka hulumtu transparencën dhe llogariëdhënien në universitetet publike, dhe botoi dy raporte në janar 2020. Raporti i parë kishte fokus menaxhimin e financave, specifikisht të ardhunat personale të stafit akademik me pozita menaxhuese në universitete publike. Përkundër pritjeve tona, raporti s'ke qaq i thatë edhe prodhoi t'dhana senzacionale. Gjetëm që disa rektorë e dekanë të universiteteve publike paguhen mbi 2000 euro në muaj. Shumë ma shumë se Presidenti e Kryeministri. Raporti i dytë kishte fokus transparencën e menaxhimit të brendshëm të universiteteve. Bazum n'kriteret tona "pikë s'kfillti", ne i kemi hulumtu universitetet publike nëse i kanë 27 dokumentet që ne i mendojmë që janë të rëndësishme për funksionimin e universiteteve. Pastaj vlerësum universitetet me notë, dhe 6 nga 7 universitetet e kaluan provimin, duke shënu përmirësim nga viti i kalum.

Nejse, n'shkurt ORCA ke posaçërisht produktive, duke botu tre raporte. Raporti i parë ka hulumtu integritetin akademik në Universitetin e Pejës ku gjetëm që janë në total 23 punime shkencore që përmbushin kriteret nga 33 profesorë. 70% e profesorëve në këtë universitet nuk i justifikojnë titujt akademikë bazum në kriterin e numrit të punimeve shkencore për t'u zgjedhur ose avancu si profesor.

I njëjti hulumtim u bë edhe n'Universitetin e Prizrenit, ku gjetëm se janë

professors of the University of Prizren do not justify their academic ranks based on the same criteria aforementioned.

Then we published a report based on our monitoring of the State Council for Recognition [of diplomas obtained outside the country] in the National Academic Recognition and Information Center (NARIC Kosova). In this report we provided information on the types of decisions taken during 2019 in this council, and the challenges they faced, with proper recommendations. Peruse at your own pleasure.

ORCA also picked a bone with the (now-former) German ambassador Christian Heldt, when we found out that he had sent an email to the Kosovo Accreditation Agency, telling them to accredit the programs of a certain private college in Kosovo with German investors. You can read the screenshots of the email in page 4 (Kronika e Zeze).

In the meantime, European countries were facing the first reported cases of the novel coronavirus. Kosovo was still unaffected, and there was a temporary bliss during February with the formation of the new government. The Ministry of Education dropped the Technology from its name, becoming the Ministry of Education and Science. The new cabinet was busy meeting ambassadors and each other during this month, based on their activity page.

In March, ORCA published a report on our monitoring of the State Quality Council, which is the board of the Kosovo Accreditation Agency. The report offered explanations on the work of the SQC, and the decisions it took during the year 2019. The report ended with the challenges this institution faces and our recommendations to deal with them. Spicy.







55 punime për 56 profesorë në total. 64% e profesorëve n'Universitetin e Prizrenit nuk i justifikojnë titujt e tyre bazum n'njëjtin kriter të sapopërmendur.

Pastaj botum një raport të bazum në monitorimin e Këshillit Shtetëror të Njohjhes [të diplomave] në Qendrën Kombëtare të Njohjes së Diplomave (NARIC Kosova). Në këtë raport ofruam informacion mbi llojet e vendimeve të marra gjatë 2019 në këtë Këshill, vështirësitë të cilat hasën, dhe rekomandimet tona. Hidhjani 1 sy n'uebfaqe tonë.

ORCA gjithashtu u kap pak me (tash ish) ambasadorin gjerman Christian Heldt, kur morëm vesh që ai e kish çu 1 email në Agjencinë e Akreditimit të Kosovës, ku ju thotë të akreditojnë programet e nji kolegji privat që ka investitorë gjerman. Mundeni me lexu emailin në Kronikën e Zezë (faqe 4).

Ndërkohë, shtetet evropiane po ballafaqoheshin me rastet e para t'raportume t'virusit t'ri korona (e thashë si Bini). Kosova ende ishte e pandikume, dhe pat nji moment qetsije e lumunije gjatë shkurtit me formimin e qeverisë të re. Ministria e Arsimit e ri-shpiku vetveten si Ministria e Arsimit dhe Shkencës (s'ka mo Teknologji). Kabineti i ri ke nxonë ty prit ambasadorë e njoni tjetrin gjatë këtij muji, bazum n'faqen e tyne t'aktiviteteve.

Në mars, ORCA e botoi një raport për monitorimin tonë t'Këshillit Shtetëror të Cilësisë, që është bordi i Agjencisë së Akreditimit. Raporti ofron informata për punën e KShC, dhe vendimet që ka marrë gjatë vitit 2019. Raporti përfundon me sfidat që ka ky institucion dhe rekomandimet tona. Bukur.

menacing music starts

then, the first coronavirus cases were confirmed in Kosovo on March 13. The government quickly locks down the country, banning flights, closing borders, telling people to work from home, and closing universities and all schools.

Hasha-boy (our former president, Hashim Thaci) asks for declaration of state of emergency, which essentially meant that he would be making the decisions on how to cope with the coronavirus pandemic in our country. Bini-boy refuses, Dulla-boy gets angry, parliament goes in session, lots of memes are born, and Bini-boy's government is voted out on March 25, with a total of 50 days in government.

Bini-boy continues governing for an additional two months until the new government led by Dulla-boy is voted in on June 3.

Higher education was quite quiet during the lockdown months, with online classes, and no major developments in legislation. Yours truly was locked away in England, drowning her sorrows in Ben and Jerry's.

On May 12, NGO Cohu's newspaper Preportr published an investigation that showed that private colleges in Kosovo had registered students in unaccredited programs, and now these students cannot confirm their diplomas in the National Academic Recognition and Information Center (NARIC Kosovo), a requirement from universities abroad if they wish to study there. Another thing these private colleges didn't do, is send a registry of students annually to the Ministry, and thus those students do not appear in the Ministry of Education's registries of students. Goody. One private college referred to the issue of them registering students in unaccredited programs as "making a mountain out of a molehill". Sure, sweetie.



muzikë horror

E tani, fillun rastet e para mu konfirmu në Kosovë më 13 mars. Qeveria menjiherë i mbylli kufijtë, aeroportin, i çoj njerzt me punu prej shpisë, i ndali fmitë prej shkolles.

Hasha (ish presidenti, Hashim Thaci) lypi shpallje të gjendjes së jashtëzakonshme, që pak a shumë i bike me i marr ai krejt vendimet për luftimin e pandemisë. Bini refuozi, Dulla u bo nervoz, parlamenti mbajti seancë, u bonen shumë fore atë ditë, edhe qeveria e Binit u rrzu, më 25 mars, plot 50 ditë në qeveri.

Bini vazhdoi me qeverisë edhe dy muj tjerë deri sa u votu qeveria e re e Dulles më 3 qershor.

Arsimi i naltë ke bajagi i qetë gjatë mujve t'karantinës, me klasa online, edhe pa zhvillime n'legjislacion. Autorja e juaj e dashtun n'këtë kohë ishte e mbyllun n'Angli, ty e mbyt mërzinë n'akullore.

Më 12 maj, botimi i OJQ Cohu, Preportr, publikoi një hulumtim që tregoi që kolegjet private në Kosovë regjistruan studenta në programe pa akreditim, dhe që këta studenta s'mujshin mi njoh diplomat në NARIC, nji kërkesë e universiteteve jashtë Kosovës për regjistrim. Nji tjetër send që këto kolegje se kanë bo, osht me dërgu nji libër amzë (regjistër) i studentëve vjetor në Ministri, dhe rrjedhimisht kta studenta nuk paraqiten n'regjistra t'Ministrisë së Arsimit, dhe s'ju njihen diplomat. Super. Nji kolegj privat i referohet problemit të regjistrimit të studentëve n'programe pa akreditim si me bo nji problem jorelevant "bjeshkë". Ani se po.

June 4 marks the start of a new era in 2020 (with January-March being paleozoic, March-June being Mesozoic, June-November being Cenozoic). He who shall not be named is appointed Minister of Education.

In July ORCA presented its annual extraordinary never-seen-before amazing fascinating report on academic integrity in the University of Prishtina. We found that 55% of the professors in UP do not justify their academic ranks based on the criteria of academic publishing. We also found that 25% of all papers produced by current professors in UP were published in the years 2017-2019, which also marks the years ORCA has been producing reports and advocating for academic integrity and scientific publishing. Not to blow our own trumpet, but .facts.

Around the same time the University of Prishtina announced fresh elections for the managing positions such as rector, senators, deans, etc. A stress-filled process filled with "I will die on this hill" declarations, produced a shortlist of three academically sound and ethically clean professors. Ultimately, Naser Sahiti was chosen as rector, and several new professors who justify their ranks were chosen as his vice-rectors, and several more were chosen as deans, producing a decent managing staff.

Naturally, there were some hiccups in the process, as they tend to happen when politically appointed people are involved. The Steering Council of the University of Prishtina consists of 9 people. Five are elected by the Senate of the university among the list of academic staff. The remaining four are appointed by the Minister of Education. When the new rector proposed his team of vice-rectors, the Steering Council were suddenly "too tired" to vote, and kept delaying the process. To this day, they still haven't voted the fifth vice-rector.

In October, ORCA re-conducted research on transparency and accountability in all public universities, publishing two reports. The first report dealt with finance management, specifically the personal income of academic staff with managing positions in public universities. We found that some rectors of public universities, and some deans of academic units in those universities get paid over 2000, some even over 3000 euros per month. Quite a lot more than our President or Prime Minister. But there were slight improvements from previous research conducted on the same topic. The second report dealt with transparency of internal management of the universities. Again, as in the previous report of the same topic, we looked at the public universities whether they have 27 documents that we deemed important for the functioning of those universities. Then we graded the universities on their transparency, with 6 out of 7 universities passing the exam, and the University of Prishtina passing with flying colours (27/27). Now we have to find some more 'necessary documents', so they don't drop the ball on this.

Ultimately, it was an eventful year, incredibly stressful, filled with political games and filth, but ORCA managed to produce 12 reports/papers, it gave out 6 grants to student organizations and groups, held 13 workshops on academic integrity and corruption in higher education for students, with 278 students participating in all of our 2020 activities.



4 qershori shënon fillimin e nji epoke të re në 2020 (janari-marsi jonë paleozoiku, marsi-qershori jonë mesozoiku, qershori-nëntori cenozoiku). Ai-që-nuk-duhet-përmendur caktohet ministër i arsimit.

Në korrik ORCA prezantoi raportin e saj vjetor t'jashtëzakonshëm fantastik t'bukur fascionues për integritetin akademik në Universitetin e Prishtinës. Gjetëm që 55% e profesorëve në UP nuk i justifikojnë titujt e tyre bazum n'kriterin e publikimit shkencor. Gjithashtu gjetëm që 25% e krejt punimeve t'botume prej profesorëve aktual në UP janë botu gjatë viteve 2017-2019, që shënojnë po ashtu vitet kur ORCA ka botu këtë raport për integritetin akademik dhe publikimin shkencor, dhe ka bo presion mbi universitetin. S'po thojmë që osht sukses i joni, po faktet jon fakte.

Në të njëjtën kohë Universiteti i Prishtinës i boni zgjedhjet për pozitat e stafit menaxhues si rektor, senatorë, dekanë, etj. Nji proces stresues i mbushun me deklarata si "ma para des unë", prodhoi nji listë prej tre kandidatësh për rektorë t'pastër etikisht e t'arritun akademikisht. Përfundimisht, u zgjodh profesor Naser Sahiti si rektor, dhe plot profesorë të tjerë të rinj e që i justifikojnë titujt u zgjodhën si prorektorë, e të tjerë u zgjodhën si dekanë, duke prodhu një trupë menaxhuese të mirëfilltë.

Natyrisht, kishte disa pengesa në proces, sic ndodhin shpesh kur persona të zgjedhun politikisht janë të përfshimë. Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës përbëhet prej 9 personave. Pesë zgjedhen prej Senatit të UP-së nga radhët e profesorëve. Katër të tjerët caktohen nga Ministri i Arsimit. Kur rektori i ri propozoi ekipin e tij të prorektorëve, Këshilli Drejtues papritmas ishte shumë "të lodhun" për me votu, dhe e shtynë procesin. Deri tash, ata ende nuk e kanë votu njërin nga prorektorët.

Në tetor, ORCA ri-bëri hulumtimin e saj në transparencën dhe llogaridhënien në universitetet publike, dhe botoi dy raporte. Raporti i parë kishte fokus menaxhimin e financave, specifikisht të ardhunat personale të stafit akademik me pozita menaxhuese në universitete publike. Gjetëm që disa rektorë e dekanë të universiteteve publike paguhen mbi 2000 euro në muaj. Shumë ma shumë se Presidenti e Kryeministri. Po kishte përmirësime t'lehta nga hulumtimi i kalum. Raporti i dytë kishte fokus transparencën e menaxhimit të brendshëm të universiteteve. Njëjtë si n'janar ne i kemi hulumtu universitetet publike nëse i kanë 27 dokumentet që ne i mendojmë që janë të rëndësishme për funksionimin e universiteteve. Pastaj vlerësum universitetet me notë, dhe 6 nga 7 universitetet e kaluan provimin, ku me këtë rast Universiteti i Prishtinë shënoi 10-shen e parë, me publikimin e 27 dokumenteve. Tash na duhet me gjet kritere tjera, që mos m'i lon rahat.

Përfundimisht, ishte një vit me plot ngjarje, stresues, i mbushun me lojna politike, por ORCA menaxhoi të publikojë 12 raporte/publikime, shpërndau 6 grante te organizata e grupe studentore, organizoi 13 punëtori për studentë me temë integritetin akademik, aktivizmin studentor, e korrupsionin në arsimin e naltë, dhe 278 studentë morën pjesë në të gjitha aktivitetet tona në 2020.



Dibran Hoxha

Kronika Rosé



Dauti ja nxjerr në pah Rronit!

-he he TABELËN



Në ni debat për çështje me rëndësi kombëtare në televizionin t7, deputeti i Kosovës Daut Haradinaj ia nxori drejtorit të ORCA-s (jo atë që po mendoni), por një tabelë që tregonte shifrat kinse milionëshe të përftimit të organizatës sonë (ORCA). Edhe pse Dauti i tha s'deshta me ta nxjerr po m'shtine, Rroni i tha nxirre, nxirre, dhe ashtu u bë.

Ata që ja dërgun këtë tabelë mendun se e bon namin, gjersa "tabelën e famshme" e kishin marrë prej faqes së KFOS, donatorit të ORCA-s, gja e cila ishte krejt transparente, për fatin tonë të keq shifrat nuk ishin miliona.

Ndërkaq, siç muni me pa panelisti tjetër Selim Selimi (ministër i drejtësisë në Kosovë) ishte pak i zënë në ato momente, ndonse u kyç ndërkohe tu i thanë se: "më vie mirë që i ke një milion" , e Rroni me modesti ja ktheu: "që i synoj 10 milion", dollar, dollar, edhe pse s'po m'i numron dora dora (insipiruar nga Dafina Zeqiri).

Ne, kolegët e Rronit nuk ishim aq t'shkathët me hulumtu aty për aty tabela për Dautin, por ma vonë i zbulum ca nga Agjencia Kundër Korrupsion e Kosovës, ku Dauti ishte deklaru si Këshilltar i Jashtëm në një kompani të Higjienës që quhet ERC trade dhe kishte përfituar rreth 18 mijë euro në vit nga kjo kompani, produktet e kësaj kompanie janë më të njohuna për shpërlarje sesa për larje.

Ju duam ‹3



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Agjencia kundër Korrupsionit
Agencija protiv Korupcije / Anti-Corruption Agency

Regjistër për deklarimin e pasurisë

Zyrtari: Daut Haradinaj / 1163300

Emri	Daut	Mbiemri	Haradinaj
Pozita	Deputet		
Emri i Institucionit	Kuvendi i Republikës së Kosovës		

FUNKSIONET DHE AKTIVITETET QË I KRYEN ZYRTARI I LARTË PUBLIK

Përshkrimi i hollësishëm i pozitave dhe funksioneve që i kryen zyrtari i lartë.

Nr	Emri i institucionit	Funksioni	Adresa	Data e fillimit
1	Kuvendi i Republikës së Kosovës	Deputet	Prishtinë	02.21.2011
2	Aleanca per Ardhmerin e Kosovës	Anëtar i Keshillit Pergjithshem	Bulevardi i Deshmorve nr 49	01.01.2008
3	E R C Trade-Prishtinë	Këshilltar i Jashtëm	Kodra e trimave	01.01.2007

Deklaruesit	Nr	Lloji te hyrave	Burimi	Vendi	Banka	Shuma
	3	Pagë	Parlamenti i Kosovës	Prishtinë	RBKO	16,536.17
	4	Pagë	ERC TRADE	Prishtinë	Banka Ekonomike	18,000.00



Shpella ime dritëpremtuese

Mua ende më kujtohen netët kur nuk flija padurim veç t'jem pjesë e gjirit tënd.

Kam ecë gjysmë dite veç me t'pa përtejë xhamit, aq e bukur m'je dukttë
sa një muaj më herët pata zgjedhë çka të vesh për ditën kur do të takoheshim.

Aq t'kam ngritë e ndritë sa shpesh them, ndoshta me kohën më është zbehë të parit mua jo drita ty.

Me futjen n'gjirin tënd kam mësu se disa dashuri mbesin dashuri veç nese s'jetohen.

E unë, unë jetoj tu t'dashtë edhe kur dielli i dritës tënde m'përvëlon.

Sa më thellë që futem gjirit tënd aq më shumë e dua vetën që zgjodha këtë rrugë
si të vetmen urë drejt andrrës sime,
edhe pse më të dashurit m'janë betu t'mos e bëj.

Nganjëherë për të jetu çlirimin që ta ofron vjellja fillimisht duhet t'helmohesh
që të kuptojmë diçka të tillë nuk është se na duhen urtakë.

"Të Hasanovite" kështu na thrrasin shokët nga Kolegjet Private dhe sillen sikur kuptojnë
nga mirësjellja mirëpritja dhe korrektësia që ofrohet brenda mureve
t'Hasanit.

Por ta dijnë që shpella jonë ngjanë me miniera, vetëm se shpellarët tanë janë më të paditur se
minatorët,
por kush t'ju vë faj se?

Gjithë ajo ngarkesë që kanë imagjino të kombinohej me dije, ç'komplikime do të sillte?



Rina Cukaj

Prandaj lum si na për ata!

Punë e madhe që vendin n'shoqëri ta jep mbiemri, apo vendin e punës ta zë e e dashura e nipit t'prorektorit,
kur pas ngritjes n'pozitë mbesa e dekanes me pretekstin se është rritë jetime e zëvendëson.

Por prap të tregohemi të kuptueshëm, ne duhet të gëzojmë që kemi jetu
në ditët kur mëshira konsiderohet avantazh.

"Jam nisë vrap, thy kambsh, përplasë dhëmbësh e çelë varrë veç t'jem copë e gurit tand,
teksa vjellë kam gjak secilën herë kur kam vendos me t'dashtë me zemër"

"O sa haherë jam nisë drejt teje barkthatë e shpirtplotë,
t'kthehesha kokëkrisur e shpirtëplasun nga gjenitë tu,
librat e të cilëve i kam lexu veç prej zorit".

Kështu shprehen për ty shokët e bursës, kur pijmë birra në oborrin tënd mbrëmjeve gjat verës.

Unë nuk t'shaj kurrë, s'kam pse.

Shpesh ua zë marri të tjerëve pezmin ndaj sistemit arsimor aktual
sikur të parët tanë nuk ranë që secili nga ne të jetë i diplomuar,
titullngritur, dhe të mbajë nga 5 puna po qe i zoti.

Unë krejt çka konsideroj të shenjtë e jetësoj në andërr, mua andrra m'ka pru këtu,
andaj shpellë më premto një gjë pos dritës një gjë të dytë t'lutem!

Nese një ditë ska rëndësi kur pra kurdoqoftë, n'ardhsha që t'groposë andrrën time n'ty, më guro!
Ca gurë shpellash konsiderohen thesarë nga disa kokëkrisur,
m'bëj gurë se s'kam andrra me t'falë!

Lëvizja studentore në Kosovë 1997 - 1999



Korab Mala

Lëvizja e parë studentore e Universitetit të Prishtinës ishte e themeluar në vitin 1997, nga zërat e fuqishëm të rezistencës siç ishin studentët e atëhershëm. Të gjithë ata sot kujtohen për protestat paqësore që kërkonin të drejtat themelore si: e drejta e arsimit shqip, ishin vitet kur pushteti serb kishte institucionalizuar gjenocidin etnik, arsimor dhe kulturor ndaj shqiptarëve. Kjo më konkretisht, ndodhi 20 vjet pas themelimit të Universitetit të Prishtinës. Gjatë periudhës së viteve të 90-ta, po në ato vitet kishte ndodhur: ndërprerja e arsimit në tre nivelet më 1991, burgosja dhe vrasja e shumë intelektualëve të atëhershëm. Këto ngjarje do të shënonin fillimin e lëvizjes, e cila ishte në mbrojtje të fjalës së lirë në Kosovë. Kjo do të fillonte me protestën e 1 tetorit 1997, ku ishin të përfshirë rreth 20 000 studentë e profesorë, të organizuar nga një lëvizje studentore, e cila ishte Unioni i Pavarur i Studentëve të Universitetit të Prishtinës (UPSUP), vepримtaria e së cilës do të zhvillohej me ëndrrën dhe synimet për arsimin shqip.

UPSUP ka qenë struktura kryesore e lëvizjes, me kryetarin e zgjedhur asokohe Bujar Dugolli, tashmë profesor në Fakultetin Filozofik dhe me personalitetet tjera siç ishin: Muhamet Mavraj, Driton Lajci, Nazmi Muzlijaj dhe Albin Kurti. Mbështetje gëzonin nga rektori dhe profesori Ejup Statovci, gjithashtu edhe nga Ambasada e Shqipërisë në Beograd, Partia Demokratike e Shqipërisë, diplomati amerikan Robert Gelbard dhe gazetat e atëhershme si "Koha Ditore" dhe "Bujku".

Si çështje kryesore që ka pasur kjo lëvizje, ishte mbështetja e kërkesave të studentëve të Universitetit të Prishtinës për t'u rikthyer në objektet publike shkollore. Kjo duke pasur parasysh faktin se gjatë asaj periudhe mësimet zhvilloheshin në shtëpi - shkolla.

Kjo çështje u ngrit nëpërmjet një plani e cila përfshiu këto faza:

- Informimi dhe sensibilizimi i opinionit të brendshëm si studentëve, subjekteve politike/jopolitike, institucioneve tjera dhe i faktorit ndërkombëtar mbi gjendjen e atëhershme.
- Formimi i Këshillit Organizativ të Protestave (KOP) dhe të nënkëshillave të çdo niveli në institucionet e arsimit të lartë në vend. Ky këshill ka pas detyrë mobilizimin dhe mbarëvajtjen e protestave.
- Fillimi i protestave.

Impakti që pati kjo lëvizje, ishte se u bë një faktorë i rëndësishëm në formimin e rezistencës ndaj okupatorit serb, kundërveprim ndaj politikës pasive të subjekteve tjera në vend. Ndikoi në sensibilizimin e faktorit ndërkombëtar, duke iu bërë me dije së në Kosovë po cenohej e drejta e fjalës së lirë dhe arsimit. Kjo revoltë u bë një dëshmi se rinia e Kosovës ishte e gatshme për rezistencë dhe veprim.


"Integriteti akademik? A na keni mësu najher për to?"

Artë Prebreza

ORCA ka inicu formimin e klubeve të etikës në fakultetet e Universitetit të Prishtinës edhe studentave fillimisht iu është kërku me marrë pjesë me nji trajnim. Kur e pashë postimin thashë ma në fund erdhi dita me e mësu se çka është integriteti akademik! Nejse, unë për veti e disha po po thom për tjerët.

Jemi mësu na sa herë të përmendet integriteti akademik me thonë "Plofesolat, plofesolat! Plagjiatula, plagjiatula". Eh, klubet e etikës janë formu me e pa që edhe na jemi pjesë e integritetit akademik. Edhe na mundemi me u përfshi në rritjen e cilësisë në arsim – prej pjesëmarrjes në trajnime e deri në mbajtjen e diskutimeve e aktiviteteve për vetëdijësim të studentave rreth dukurive negative që ndodhin në Universitet. Me ja nisë krejt m'i pa studimet si proces i rëndësishëm e jo me u lutë m'i kry sa ma shpejtë!

Mos u demoralizoni, nuk është aq e komplikume sa duket. Për shembull, duke parë që profesorët kanë dhjetëra mentorime brenda nji viti, ne kemi shprehë gatishmëri të bëjmë kontrollimin e temave të diplomës. Tash na eksperta nuk jemi, po të paktën nji herë mundemi me i lexu prej fillimit deri në fund. Kjo besojmë që do të ulë dukshëm numrin e diplomave të blera (edhe pse kjo mundet me ndiku negativisht në ekonominë e Kosovës). Në meny kemi edhe metoda të tipit "tap-rrap" për zgjidhjen e problemeve. Nëse e sheh kolegun tu kopju - me telefon, sllajde apo edhe me shishe të ujit – nisja kollitu shumë edhe bonja me sy profesorit ka kolegu që po kopjon. Kështu edhe kolegu s'tu idhnohet edhe i ke punët mirë me profesorin edhe ndikon në rritjen e cilësisë në arsim mbi të gjitha.



Profesorave… Nejse këtu s'kemi hala diçka konkrete ama besojmë që mundemi me mbërri nji marrëveshje me Këshillin e Etikës që secili profesor që ka bo plagjiaturë me pasë detyrë shtëpie me shkrujt në fletore 100 herë "Unë nuk bëjë më plagjiaturë!" Ndoshta edhe naj thupër duarve, s'ish konë keq… E di, e di, a rrehet institucioni Artë? Po na s'marrim vesh ndryshe bre! Se kanë pasë keq kur kanë thonë që dajaku prej xhenetit ka dalë.

Normal që anëtarësimi në klube të etikës i ka edhe benefitet e veta. Ma s'pari, nëse ti i monitoron të tjerët, s'ka kush të monitoron ty. Besojmë që me kalimin e kohës do të fitojmë të drejtën edhe me regjistru studenta e me hi në provim për njoni tjetrin. Na si njerëz etik duhet me i ndihmu njoni tjetrit. Pse, çka kanë organizatat studentore ma shumë se klubet?

Prandaj, për me mësu ma shumë rreth integritetit akademik edhe me u çu me bo diçka e mos me nejt veç tu u anku, hajde në klub të etikës. Krejt çka ju duhet është me qenë njeri shumë etik, sypatrembur dhe largpamës (literalisht). Po ju lë me fjalët e Marin Barletit "Habetis bona deum!"

ORCA ka përzgjedhur pesë hartime nga konkursi i shpallur për studentë, me temën "Arsimi në vitin 2020", lëshojani ni sy!

MBI SHKOLLËN, TË PASHKOLLËT



Alisa Rashiti,
studente e vitit
të dytë në
Universitetin
"Hasan Prishtina"

"Zëvendësministri i emëruar është Driton Bardheci. Ky i fundit vie nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, ndërkohë vazhdon studimet në Universitetin e Prishtinës", është lajmi që mbuloi për pak orë ballinat e portaleve te ne. Mirë thashë, ndoshta ky do t'i ketë më të freskëta telashet që kanë studentët. Aq larg sa prej problemeve, me gjasë zëvendësministri ynë po qëndronte edhe me vet rezultatet e tij në studime. Nota e tij mesatare prej 6.8 nuk shpërfaqte shumë optimizëm te audienca e gjerë.

Megjithatë, ndoshta ishte thjesht mendim fillestar; po gjykonim thuajse notat paraqesin vlerën reale të njohurive në universitetin më të madh publik në Kosovë. Por zëvendësministri ynë student, shumë aktiv s'u pa as në pozitën e tij të re. Përveç një arsyetimi për emërimin e tij, një heshtje varri mbizotëroi sot e asaj dite. Mediat e zhurmshme, ranë në gjumin e arushës, pasi që si gjithmonë, në vendin tonë të rëndësishme janë vetëm lajmet bombastike.

E ndoshta qetësia e tij erdhi për shkak të zhurmës në vendin e ri të punës. As aty nuk ishte gjithçka në rregull. I pari i institucionit ku ai është punësuar, ministri Ramë Likaj ka kohë që akuzohet për plagjiaturë. Por ç'rëndësi ka, rendi e do që ministritë të ndahen mes partnerëve të koalicionit, në mënyrë që askush të mos ngec pa një pjesë të tortës. Gjithçka po funksionon si duhet, karriget do të ngrohen, ndërkohë sistemi arsimor si gjithmonë është shkatërruar nga "të tjerët".

Epo ndoshta nuk duhet që t'i fajësojmë vetëm të mëdhenjtë, pasi që faji është zinxhiror, apo jo? Është Rrahman Jasharaj nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, të cilin e mbani mend për shkak të kritikave të ashpra për cilësinë e arsimit në Kosovë. Apo, jo? As unë! Prej që mbaj mend, i njëjti kërkon ngritje pagash pasi që mësimdhënësit duhet të trajtohen në mënyrë më të dinjitetshme. Nga ky organizëm do të ishte "skandaloze" po të kërkonin përgjegjësi më të madhe për ata të cilët synojnë të edukojnë gjenerata të tëra.

Përgjegjësia është fjalë e panjohur shpesh edhe në institucionet e nivelit të lartë arsimor. Sipas raportit vjetor të auditimit, rreth 80 mësimdhënës në Universitetin e Prishtinës, kishin kryer edhe një punë sekondare, pa leje të institucionit që menaxhon punën e tyre- pra pa leje të Rektoratit. Mirëpo as kjo nuk ka rëndësi, sepse një rrogë më shumë do të thotë një jetë më të mirë, tek e fundit ç'rëndësi ka, nuk do të jetojmë 100 vjet.

Disi si të hutuar qëndrojnë në prapavijë ata për të cilët paguhet edhe ministri, zëvendësministri, mësimdhënësit e sindikatat. Nxënësit e studentët kurrë më parë nuk kanë qenë më të heshtur përballë kësaj gjendjeje. Por se janë të koncentruar në shkencë, nuk na do mendja pasi që sipas rezultateve të testit PISA, arritjet e tyre në këtë fushë nuk janë për lëvdata.

E tani ndoshta dikush do t'i shfajësojë profesorët, të tjerët ministrin, e të tjerë do thonë se fëmijët e tyre janë gjeni. Por nuk mund të ketë përmirësim të cilësisë së arsimit, kur të gjithë të lartpërmendurit nuk investojnë në veten e tyre, në arsimimin e tyre në mënyrë që këtij shteti t'i ofrojnë pak më tepër se injorancë.

Arsimi në vitin 2020



Elitë Bardhi,
studente e vitit
të parë (MA) në
Universitetin
"Kadri Zeka"

Ky vit ishte vit i simulimeve akademike. Vit i testimeve të mësimdhënësve e profesorëve, prindërve e gjyshërve ndaj tempullit të dijes, i cili tani nuk konsiderohet veç si objekt, por edhe si platformë.

Pandemia e shkaktuar nga Covid-19 na detyroi "dhunshëm" që procesi i mësimdhënies të kaloj online. Ndonëse ne jemi shumë të përgatitur dhe të përshtatshëm karshi ndryshimeve, hasëm në Don Kishotët bashkëkohor të cilët u revoltuan nga propozimet e atyre që ishin përgjegjës për shëndetin kolektiv.

Bile hasëm në të tillë që ironizonin me katundet e tyre si Universitet në vete dhe nuk pranonin assesi të 'nënshtroheshin' botës digjitale dhe platformave aktuale që përdoreshin.

Kaluam fazën test 1, test 2 dhe më në fund adaptuam mësimdhënësit me këtë stil jete. Bile, ne studentët fort përfituam... prezenca jonë dhe e mësimdhënësve ishte për lakmi. Ne përshëndetëm rregullsinë e mësimdhënësve dhe përgatitjen e tyre në mësim online, ashtu siç po e pranojmë si të mirëqenë prezencën tonë (ndonjëherë fiktive).

Gjithsesi...

Në pisa nuk u testuam, veç tani pandemia na solli testin kolektiv në TIK, lëndën nostalgjike të "batit" të prindërve e gjyshërve tanë... Platformat e simulimet me to u bënë përditshmëri e jona, zaten nuk kujtojmë gjë tjetër pos Zoom, Google classroom, meet, BigblueButton etj. Arsimi ynë u lidh ngushtë me funksionimin e internetit, energjinë elektrike e posedimin e teknologjisë SMART.

Disi u pa me sy skeptik i tërë procesi, e po vazhdon të shihet nga të tjerët. Por, ne të cilët kaluam përgjatë këtyre muajve në ligjërata, ushtrime e besa diplomime online, po e konsiderojmë deri diku të suksesshëm e plotë sfida, kjo pikërisht për efektin psikologjik që pat ky angazhim.

Si përfundim, mund të konsiderojmë si vit të mbushur sfida, tentime për të qenë më të mirë seç jemi dhe për të promovuar (pseudo)aftësitë tona aktuale për menaxhimin e suksesshëm të procesit mësimor në distancë dhe jo vetëm. Me shpresë që përgëzimet, like-t dhe komentet nga miqtë e dashamirët të na shtyjnë të jemi më të mirë në vitin tjetër

Arsimi në vitin 2020



Albin Badalli, student i vitit të dytë në Universitetin "Hasan Prishtina"

"A po dëgjohem?" – pyet profesori ose profesoresha.

"Po, prof" – përgjigjen disa prej studentëve që po e dëgjojnë ligjëratën online, e disa sa për të krijuar përshtypjen që po e dëgjojnë atë (dhe një pjesë e mirë e tyre ende po shikojnë ëndrra ne gjumë).

Është kjo një bisedë e zakonshme midis profesorëve dhe studentëve, e cila përsëritet disa herë gjatë një ligjërate (në vitin 2020, kuptohet). Por çka na mëson ky vit i pazakontë për arsimin në vendin tonë ?

Arsimi është një nga shtyllat fundamentale të shoqërisë, nga i cili përcaktohet rrjedha profesionale, intelektuale e akademike e një vendi. Si e tillë konsiderohet në vendet me traditë qindra apo mijëra vjeçare në këtë lami, por që nuk mund ta themi të njëjtën gjë për vendin tonë, në të cilin jo shumë kohë më parë vajzat nuk janë lejuar të arsimohen. Arsimi, pra, është një iniciativë relativisht e vonë e shoqërisë sonë (gjë për të cilën nuk është krejtësisht faji ynë), dhe një iniciativë, e cila fatkeqësisht ka marrë drejtim të gabuar (gjë për të cilën është krejtësisht faji ynë).

Për t'iu përgjigjur pyetjes që e parashtrova në paragrafin e dytë, më duhet t'i shqyrtoj dy gjëra. E para, mosndjenja e obligimit për ndjekjen e ligjëratave nga ana e studentëve, dhe e dyta, mënyra e organizimit të mësimit online nga institucionet përkatëse. Çështja e parë lidhet me atë se si e kemi (keq)kuptuar arsimin ndër vite, duke e ndjekur sipas mënyrës së njohur në vendin tonë, "shkel e shko", dhe duke mos pasur një vizion të qartë për mbarëvajtjen e tij, e lëre më për të bërë reforma, të cilat janë aq të nevojshme. Kurse, çështja e dytë, shpërfaq edhe më tej problemet me të cilat përballet arsimi. Një shpërthim i tillë i pandemisë COVID-19, ishte i papritur për të gjithë globin, e organizimi i jetesës ne këto kushte u shndërrua në një sfidë të cilën ende nuk e kemi kuptuar plotësisht. Organizimi i arsimit në këto kushte, duke mos e rrezikuar shëndetin e pjesëmarrësve në një vend ku pandemia nuk është problemi i vetëm në arsim, lë për të dëshiruar. Ah, në këtë rast, po ashtu mësuam se disa prej profesorëve nuk dinë ta përdorin kompjuterin ☺.

Fakti që viti 2020 do të jetë i mangët në arsim është i ditur, por në ç'shkallë është kjo mangësi do të kuptohet kur këto njohuri të fituara në shkolla e universitete do të duhet të zbatohen në praktikë. Pandemia COVID-19 do të përfundoj, jeta do t'i kthehet normalitetit, por me këtë nuk do të përfundojnë edhe problemet në arsim. Neve na mbetet t'shpresojmë e t'punojmë që të kuptohet rrënjësisht rëndësia e arsimit, vetëm në këtë mënyrë arsimi do ta zë vendin që e meriton, vëmendjen e çdo hierarkie institucionale.

Andaj, arsimi në vitin 2020 është pasqyra më e mirë e përkushtimit tonë mbarëshoqëror në çështjet që në t'vërtetë kanë rëndësi, pamja e së cilës nuk do t'na pëlqej shumë (me rëndsi shneta :P).

VITI 2020 VË NË PAH SFIDAT E ARSIMIT NË KOSOVË



Eliza Sadiku, studente e vitit të dytë në Kolegjin "Universum"

(16:30) Kur me orar zyrtar, i cili gjendet i gozhduar në muret e Universitetit të Prishtinës, brenda dy minutave do të fillojë ligjërata, asgjë nuk është në vendin e duhur. Studentët të shpërndarë nëpër korridore po diskutojnë se cila parti në Kosovë është më e drejta, e cila duhet kryqëzuar. Brenda sallës nuk gjendet askush, pasi që me gjasë nxemjet qendrore nuk po funksiononin aty.

(15 minuta më vonë) I quajnë pesëmbëdhjetë minuta akademik, prandaj debati po vazhdonte normalisht. Profesori nuk po shfaqej, por kjo çuditërisht nuk po e çuditë asnjërin nga ta. Dukej se gjithçka që po ndodhte, ishte më se normale. Profesori kishte autoritetin për të vendosur kur do të fillonte ligjërata, prandaj të gjithë të tjerët do t'i nënshtroheshin këtij rregulli të artë.

(30 minuta më vonë) E është ky pikërisht momenti kur studentët filluan të merakoseshin pse profesori nuk po shfaqej në skenë. Kjo pasi që në kushte normale, ligjërata mund të përfundonte deri tani. Atëherë njëri që e konsideronte veten si më të zotin në mesin e shoqërisë, telefonon profesorin:

"Profesor përshëndetje. Jemi duke të pritur për ligjëratë, a do të vish?"

"Jo, e kam një rast urgjent prandaj nuk do e mbajmë ligjëratën. E zëvendësojmë ndonjë ditë tjetër, ju njoftoj për kohën dhe vendin."

Kështu korridori i mbushur me studentë, papritmas zbrazet. As edhe njëri prej tyre nuk e sheh si të jashtëzakonshme sjelljen e profesorit, sepse ai thjesht ka autoritet. Por javën e ardhshme i njëjti vie në sallë me dy lista, ku të gjithë studentët pa e diskutuar dy herë, nënshkruajnë me emër e mbiemër se ligjërata është mbajtur. Kësisoj gjatë evidentimit të mungesave, profesori do të rezultojë se ishte i rregullt në ligjëratë, por atëbotë ai ishte diku nëpër Ballkan duke soditur bukuritë e natyrës.

Por kur ligjërata fillon dhe hapet pjesa e diskutimit, më të mirët për profesorin janë ata që miratojnë fjalët e tij. "Problematikët" e ligjëratës do të cilësohen ata të cilët hezituan të mendojnë njësoj dhe e vunë në pikëpyetje atë që po diskutohej. Kjo pasi që interaktiviteti në institucionet tona arsimore, është sa për sy e faqe. Zakonisht në qendër të orës mësimore janë mësimdhënësit, ndërkohë tërësisht pasiv qëndrojnë nxënësit e studentët.

Fatkeqësia u shtua kur mësimi filloi t'i drejtohet botës virtuale. Evidentimi i prezencës së studentëve ishte minimal, prandaj edhe të dhënat e nxjerra nga Rektorati për vijueshmërinë, ishin aspak të sakta. Kjo pasi që secili student që kyçej me një pajisje, nuk do të detyrohej të vërtetonte prezencën e tij, pikërisht për shkak të mungesës së interaktivitetit.

Veç shumë sfidave të tjera, ky vit ka vënë në pah mangësitë e arsimit në Kosovë, pasi që mungon kultura e komunikimit, diskutimit kritik, e që mund të vërtetohet lirisht me prezencë në të paktën një ligjëratë, ku studentët janë ata që marrin si të mirëqenë gjithçka që u servohet para.

Prandaj raportimi i UP-së se në periudhën 16 – 19 mars 2020, janë mbajtur 1529 ligjërata, duke dëshmuar interesim dhe pjesëmarrje të jashtëzakonshme të stafit dhe studentëve në mësim virtual, vërteton më së miri se si të gjithë mbyllin sytë para një realiteti të trishtë, që flet për cilësinë e arsimit në Kosovë.



Elona Sahiti,
studente e vitit
të katërt në
Universitetin
"Hasan Prishtina"

Pandemia arsimore s'ka vaksinë

Një virus me kurorë, ashtu siç e mban mbretëresha e mbreti, na mbylli të gjithëve brenda shtëpive tona. Gjithçka tonën e ndryshoi, madje na dirigjoi e ende po na dirigjon edhe mësimin, ligjëratat e angazhimin akademik.

Prej rregullimit para pasqyrës për t'u nisur drejtë fakultetit, përfunduam me pizhame nga krevati duke mbajtur ligjëratën e kështu në të njëjtën pozitë vetëm duke përpëlitur më shumë sytë përfunduam orën, semestrin, provimet e madje edhe vitin.

Telashe gjithandej.

Profesorë që nuk ia kanë haberin platformave online, mezi u stabilizuan vetëm për kyçje me studentë. Pas shumë viteve në ligjërim, të njëjtit mësuan edhe më mirë të përdorin ato e-mail të cilat me gjasë vetëm për hijeshi i kanë mbajtur në karrierën e tyre.

"Nuk po nihesh bre profesor!" dhe "Oo sen nuk po të dëgjoj oj studente!"- janë fjalët që më së shpeshti i kam dëgjuar në këta muaj ligjërata.

Pavarësisht kësaj, po ambientoheshim ashtu siç kishim mundësi.

Mirëpo, qetësi e mundësi për nxënie të mësimit nuk kishin studentët në zona të thella. Atje ku mezi arrijnë valët, studentët i kapte zija dhe t'u mos pasur kushte teknologjike ata diskualifikoheshim në mos aktivitet. Ne edhe fizikisht nuk kemi kushte të mira për të zhvilluar aktivitete e ligjërata qysh ia do rendi, e le më të merremi me platforma të cilat deri në këtë vit nuk kishim dijeni që ekzistonin.

Thoni ju, mungesat e profesorëve në platformat online janë evituar. Nuk është aspak e vërtetë!

Duke mos pasur shumë "inspektim" mbi atë se qysh po zhvillohet ora e java, mes raportit profesor-student, lojërat ishin shumë prezentë. Online kemi qenë por as ne e as profesorët fjalë nuk kemi shkëmbyer. Eh, a e dini pse?

Qe po ua them unë: Ata kapin një vend pune këtu, një vend pune aty dhe duke mos pasur mundësi t'i arsyetojnë të dyja angazhimet, zgjedhin aty ku mund të jesh dinak e të tërhiqesh në mënyrë diplomatike.

Po, Po… Ne online kemi qenë, edhe kemi figuruar në regjistrimin e platformës GOOGLE MEET, por asgjë nuk kemi mësuar. E më e rënda e kësaj meseleje është që në vlerësim, pyetjet janë të nivelit dhjetë por ne nuk kemi çfarë të përgjigjemi, se më parë nuk kemi arritur të mësojmë asgjë.

Mungesë e pa mungesë, çka mësuam – mësuam; çka nuk mësuam s'mësuam, viti akademik 2019-2020 u mbyll e filloi 2020-2021.

Diçka që do të mbaj mend përgjithmonë nga të gjitha këto javë mësimi janë: Kaosi, ndërprerjet e sinjalit, mungesë interneti, kakofoni, të qara të fëmijëve më sfond, thithëset elektrike, futboll, lajme e klithma të një zëri atje më larg: Kuku, prapë paska të vdekur e sa njeri koka infektu!

Por, më shqetësuese se koronavirusi, është sistemi i arsimuar i infektuar tash e sa vite. Me aq sa di, pandemia zgjatë më së shumti tri vjet, por cilësia e arsimit më tregoni ju sa vite kërkon të përmirësohet?